



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 545/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Pedagogji, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
  - Edukimi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (0-3 Vjeç), BA, 240 ECTS.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Edukimit ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Pedagogji, MSc, 120 ECTS, dhe Edukimi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (0-3 Vjeç), BA, 240 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Pedagogji	MSc	120	Fahri Marevci, Jehona Miftari-Ferizi, dhe Vlora Sylaj
2	Edukimi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (0-3 Vjeç)	BA	240	Ganimete Kulinxha, Ilir Muharremi, dhe Nusret Pllana

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin të Edukimit më 16.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Frederking dhe Melita Kovacevic.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Edukimit, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit Edukimi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (0 – 3 Vjeç), raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, vërejtjet më serioze për sa i përket këtij programi të studimit janë të lidhura me strukturën e lëndëve, përmbajtjen e tyre dhe me përzgjedhjen joadekuate të literaturës. Nuk është transparente dhe nuk ka ndonjë logjikë se pse shumica e lëndëve kanë një ndarje mes 60% të punës teorike dhe 40% të punës praktike. Ekspertët kanë mësuar se i gathë programi i studimit e ndjek skemën e njëjtë të ndarjes së punës teorike dhe praktike, me vetëm disa ndryshime të vogla. Sipas tyre, nuk është e kuptueshme se pse disa lëndë kanë punë praktike, ndoshta sepse fakulteti ka marrë një vendim të përgjithshëm për këtë çështje pavarësisht përmbajtjes së lëndëve.

Duke pasur parasysh se programi i dedikohet fëmijëve nga mosha 0 deri 3 vjeç, ekspertët kanë deklaruar se është shumë çështje serioze se pse nuk ka asnjë lëndë e cila lidhet me shkencat mjekësore. Po ashtu përshkrimi i lëndëve dhe literatura e vendosur për lëndë është çështje serioze. Shumica e lëndëve nuk përshkaten me target grupin e programit, fëmijëve 0 deri 3, dhe shumë lëndë dhe përmbajtje të tyre duket se janë marrë nga programe të tjera ekzistuese që kanë tjetër target grup të programit.

Po ashtu qasja në bibliotekë dhe titujt e nevojshëm është një brengë serioze. Ekspertët kanë dëshmuar se biblioteka nuk është funksionale dhe ka numër të limituar të titujve, nuk ka revista dhe se nuk ka kapacitete të duhura humane.

Në anën tjetër sipas ekspertëve ndarja dhe alokimi i kredive nuk është bërë në mënyrë transparente dhe nuk përcjell ndonjë logjikë për një ndarje të tillë. Për shembull për ekspertët nuk ka qenë e kuptueshme se pse tek lënda Lojërat Matematikore janë vendosur 7 ECTS duke pasur parasysh se ky program i dedikohet moshës 0 deri 3 vjeç.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Edukimit;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë